

MUSTAFA DEMIRI

(1923 –1985)

DINGA L.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Kopshti Botanik i Tiranës

Ky takim organizohet për të përkujtuar 50-vjetorin e të parit universitet në Shqipëri dhe figurën e Mustafa Demirit. Jo pa qëllim janë lidhur bashkë. Ngritja e Universitetit të Tiranës është ngjarja për të cilën është vështirë të gjejsh epitelin e goditur si institucioni më i rëndësishëm i arsimit të lartë, i ëndërruar nga breza të tërë mëndjesh të ndritura të vendit. Mustafa Demiri, figurë e shquar e botanikës shqiptare, ideatori dhe themeluesi i Kopshtit Botanik, punonjës i Universitetit të Tiranës nga dita e parë e tij.

Mustafa Demiri u lind në qytetin e Elbasanit më 13 Maj 1923. Babai i tij ishte punëtor. Ai ndoqi shkollën Normale, por për arsye ekonomike, gjatë shkollës ka punuar edhe si shegert. Pasi mbaroi Normalen, në vitin 1945-46, punoi si mësues në rrethin e Gramshit. Në vitin 1946 filloi studimet e Larta për Biologji në Zagreb, dhe i mbaroi në vitin 1951 në Sofie. Pas mbarimit të studimeve të larta, për një periudhë të shkurtër punoi pranë Ministrisë së Arsimit, në degën e teksteve dhe më pas, si mësues në gjimnazin e Shkodrës. Në vitin 1952 emërohet punonjës shkencor në Institutin e Shkencave, pranë Sektorit të Florës. Me krijimin e Universitetit të Tiranës në vitin



1957, vjen si punonjës shkencor në Katedrën e Botanikës. Në vitin 1965 caktohet përgjegjës i Kopshtit Botanik të Universitetit të Tiranës, detyrë të cilën e kreu me pasion e përkushtim deri në qershorin e vitit 1985, kur u nda nga jeta. Gjatë kësaj periudhe ai mbajti leksionet e Sistematikës së Ulët të Bimëve dhe të Fitogjeografisë së bimëve në Fakultetin e Shkencave Natyrore.

Demiri mban Çmimin e Republikës, titullin Mësues i Popullit dhe disa urdhëra e medalje pune. Ai mbetet figurë e shquar e shkencës shqiptare, botanisti me punime e botime të shumta e të plota. Për 30 vjet, grumbulloi, përpunoi, studioi shumicën e bimësisë së vendit, duke botuar rreth 100 tituj shkencorë e mësuesorë, me mbi 6000 faqe, brenda e jashtë vendit, në disa fusha, si floristikë, fitogjeografi, gjeobotanikë, fitotekni etj.

1. Punimet për grumbullimin e studimin e bimësisë dhe hartimin e Florës së Shqipërisë. Këto mishërohen në ndihmesën e tij për formimin e Herbarit Botanik Kombëtar, në shumë artikuj shkencorë dhe vepra, si Flora e Tiranës, dy përcaktues bimësh: Flora e Vogël e Shqipërisë dhe Flora Ekskursioniste e Shqipërisë, të cilat i paraprinë vëllimeve I dhe II të Florës së Shqipërisë (si bashkautor). Kjo veprimtari ka dhënë dhe mbete ende ndihmesë e madhe për studentët, pedagogët dhe gjithë të interesuarit e tjerë të florës dhe bimësisë natyrore të vendit tonë. Për vlerat shkencore, këto dy vepra kanë tërhequr vëmendjen edhe të shumë specialistëve të huaj, duke dëshmuar për një ndër njohësit më të mirë të florës së vendit tonë e më gjerë.

2. Punimet studimore dhe eksperimentale mbi përbërjen, shfrytëzimin dhe përmirësimin e kullotave dhe livadheve. Këto përfshihen në Disertacionin e tij 'Mbi Biologjinë, vlerat ushqyese e prodhimtarinë e kullotave në Shqipërinë e Mesme', në disa monografi, mbi bimët foragjere dhe ato të dëmshme të kullotave. Sintezë e kësaj pune është vepra *Manual për Kullotat*, e cila përmban përbërjen floristike, vlerat ushqyese të bimëve të kullotave dhe një program veprimi për shfrytëzimin racional dhe përmirësimin rrënjësor të tyre.

3. Punimet për vlerat e dobishme ekonomike, mjekësore, etero-vajore, mjaltore dhe për dëmshmërinë e bimëve spontane. Përfundimet e tyre përmbledhën një radhë artikujsh shkencorë dhe vepra, si *Vademekum i Bimëve Mjekësore* (si bashkautor), *Bimët e Egra të Dobishme dhe të Dëmshme të Vendit Tonë*, e cila përfaqëson një pasqyrë enciklopedike të vlerave të shumanëshme të bimëve të dobishme, të mënyrave të përdorimit të tyre dhe të rrugëve të luftimit të bimëve të dëmshme.

4. Kopshti Botanik i Universitetit të Tiranës është monumenti i gjallë edhe i punës shkencore të M. Demirit. Ai përpunoi idenë e projektimit, në bazë kriteresh shkencorë moderne, drejtoi shkencërisht zbatimin e projektit, udhëhoqi tërë punën shkencore për pasurimin dhe shndërrimin e këtij institucioni në një qendër të rëndësishme me vlera shkencore, mësimore, kulturore dhe edukative.

Mustafa Demiri është personalitet i shquar i shkollës dhe arsimit shqiptar. Për 35 vjet, si mësues e pedagog, ai zhvilloi leksione në 5-6 disiplina, hartoi një

rradhë dispensash e teksteve si autor dhe bashkautor për profilet e Biologjisë, Gjeografisë, Farmacisë, Agronomisë etj. Leksionet e tij shquheshin për nivel shkencor, metodikë të përsosur, qartësi e aftësi tërheqëse, për timbër të ngrohtë. M. Demiri është ndër autorët më të njohur të teksteve për shkollat e mesme e 8-vjeçare, duke qenë autor dhe bashkautor i 12 teksteve dhe atlaseve botanike. Përmendim tekstin e Biologjisë për klasën e 5-të, Atlasin e Biologjisë për klasën e 5-të dhe të 6-të, Harta e Bimësisë së Shqipërisë (me bashkautor) etj.

Ka qenë ndër lektorët e dalluar në Fakultetin e Shkencave Natyrore, në degën Biologji-Kimi, në lëndët e Sistematikës së Bimëve të Ulëta dhe atë të Fitogjeografisë. Gjeografia e Bimëve ishte i pari tekst universitar i llojit të tij në vendin tonë. Në të një kapitull i veçantë i kushtohet Florës së Shqipërisë, duke vënë në dispozicion të studentëve një informacion të plotë për florën e veçanërisht për vegjetacionin e Shqipërisë, të cilin në vitin 1985 e ripunoi tërësisht. Ai për shumë vite ka drejtuar edhe praktikën në terren të kësaj discipline, ku spikati si dashuria, respekti për studentët, ashtu dhe serioziteti në kërkesa. Ai ka dhënë kontribut të veçantë edhe në hartimin e teksteve për shkollën 8-vjeçare e të mesme.

Si anëtar e aktivist i forumeve drejtuese të shumë institucioneve shkencore e shtetërore, M. Demiri ka dhënë ndihmesë të rëndësishme për mbarëvajtjen e punës së tyre, si Këshillave Shkencore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, të Ministrive të Bujqësisë dhe të Ekonomisë Komunale, të Institutit të Lartë Bujqësor, të Instituteve të Foragjereve e të Pyjeve, si anëtar i Komitetit të Shkencës e Teknikës etj.

Si studente e kam të fiksuar profesorin në kujtesë me këpucë alpine, kostum doku, kasketë dhe aparat fotografik, si shqisa e tij plotësuese. Ai ecte përpara dhe studentët e ndiqnin nga pas; i palodhur, i papërtuar, i aftë, i butë, me një aftësi komunikuese si ai, kërkues deri në hollësi kur kishin interes; i drejtë në vlerësim. Sa herë i kam bërë pyetjen vetes se ku qëndronte kjo aftësi e veçantë e tij për t'i bërë të gjithë studentët për vete. Unë pata fatin të shoqëroja praktikën në terren me Prof. Mustafain për disa vjet duke qenë kolegia e tij. Kjo pyetje më vinte shpesh edhe për faktin se ai nuk është se bënte lëshime; p.sh në orar ishte i përpiktë deri në minuta; kur thoshte se do nisemi në ora 7-të, nisej fiks në atë orë; na kishte ndodhur ndonjëherë që ndonjë student të vonuar ta linim. *-S'ka gjë se vjen e na gjen vetë* – thoshte profesori. Dhe kështu ndodhte. Bëhet fjalë për praktika të Fitogjeografisë që i bënim në të gjithë Shqipërinë. Megjithatë, asnjë student nuk mërziqej, nuk kundërshtonte, përkundrazi rreth 20 breza studentësh që kemi kaluar sëbashku me profesorin ruajnë kujtimet më të mira e respektin më të lartë për të. Edhe

në leksion ishte i saktë, i ngadaltë, lakonik, konkret e plot mbresa nga studimet e tija në terrenin shqiptar. Nga shumë i afërt e i butë në praktikë, aq korrekt e kërkues në provim; i duruar për të dëgjuar deri në fund, revoltues kur konstatonte gabime të rënda e objektiv në vlerësim.

Si kolege, natyrisht e njoh përsëri gjatë; kam punuar 17 vjet me të; e kam patur udhëheqës në punën shkencore, udhëheqës në dhënien e mësimit, këshilltar në jetë dhe shok të mirë. Me një vullnet për punë që rrallë takohet; mund të them deri në abuziv për orar pune e pushimi, sigurisht në kurriz të së drejtës. Nuk njihje ditë pushimi, të diela, madje as edhe festa. Më kujtohet një vit e kam takuar në rrugë më datë 2 janar; më tha se kishte qenë për të punuar në Kopësht. Këtu dua të ndalem në binomin Mustafa Demiri – Kopshti Botanik. Ai i kushtoi Kopshtit Botanik 20 vjetët e fundit të jetës. Pas familjes, vinte Kopshti. Me aftësi profesionale e konceptoi, me dashuri e pasion e ndërtoi. Si këmbëngulës në të gjitha punët në Kopësht kjo karakteristikë e tij u çfaq tërësisht dhe u konkretizua me rezultatin – Kopshti Botanik i Tiranës, modern, me tematikë shkencore dinjitoze, i bukur dhe me mundësi të mëdha zhvillimi të mëtejshëm. Ai bëri shumë vepra, por Kopshti Botanik është kryevepra e tij. Kur punonte nuk gjente kohë as për të pushuar. Ne punonim shpesh bashkë dhe ndërkohë fillonte të hante mëngjesin, njëkohësisht dhe shkruante. Gjithmonë i thoja: *–Profesor, unë po pres, mbaroni njëherë së ngrëni*. – Përgjigjen e dija: *–Vazhdo, vazhdo*. Për këtë do ta kritikoj.

Në botë ka shumë njerëz të mirë, por Prof. Mustafai ishte nga ata të mirë që zbulohet menjëherë si i tillë. Qysh në takimin e parë njerëzit thonin: *–Sa burrë i mirë!* Dhe kjo sepse Profesori nuk dallonte shoferin nga ministri. I butë, i ngadaltë, i qeshur, tolerant, i çiltër me të gjithë. Tipari më karakteristik i tij në marrëdhënie me njerëzit ishte aftësia e jashtëzakonshme komunikuese, të cilën pak njerëz e kanë. Në sajë të saj ai gëzonte simpati nga një rreth i gjerë njerëzish, të cilët e çfaqin edhe tani sa herë që bie fjala për të ...; dhe fjala në Kopshtin Botanik bie gjithmonë për Prof. Mustafain.

Tani besoj se Prof. Mustafai ishte i ndërgjegjshëm për respektin e të tjerëve ndaj tij. Por kurrë nuk e çfaqte shenjën më të vogël të sundimit mbi të tjerët, pa folur që tek ai nuk vemë re asnjë çfaqje mëndjemadhësie; madje unë do të thoja sikur ishte më i thjeshtë nga sa duhej. Kjo e lejonte të merrte mendime nga të tjerët; meqë punonim shumë bashkë, shpesh pa asnjë ngurim më pyeste për çështje që mendonte se unë mund t'i dija. Ai shfaqte gjithmonë respekt të veçantë për gratë në përgjithësi; këtë e pohonte edhe vetë, dhe e zbatonte deri në marrëdhëniet e përditshme në punë; nuk ndodhte që profesori të hynte para të tjerëve në një zyrë, në një auditor, madje as në zyrën e tij; dhe kështu vepronte me të gjithë, veçanërisht me gratë.



Pamje nga Kopshti Botanik i Tiranës, qershor 2007

Përveç punës në Kopshtin Botanik, në floristikë etj., pasioni i Prof. Mustafait ishin piktura, dhe sidomos fotografia; ai kishte shpirt artisti që e çfaqte në vlerësimin e së bukurës në përgjithësi, të natyrës e të rregullit. Me fotografitë krijoi një filmotekë të pasur me bimë, bimësi, pamje natyrore nga i gjithë vendi. Edhe librat i kishte ilustruar me fotografitë e tij.

Profesor Mustafai ishte njeri, shkencëtar, artist e shok i mirë. Edhe pse nuk i qe dhënë titulli Profesor, ai e mbajti atë, dhe sot e konsiderojnë të gjithë krejtësisht të merituar.